



Cërrik, më 01/02/2023

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" neni 17,

1. “ **PROGRAMI I BANESAVE SOCIALE ME QIRA**” (BSQ), neni 40

2. “**PROGRAMI PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE**”, neni 44 3. “**PROGRAMI I BANESAVE ME KOSTO TË ULËT**” (BKU)

VKM Nr. 384, datë 12.06.2019 "Per percaktimin e dokumentacionit për të përfituar Strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e veteqeverisjes vendore"

Komisioni i Strehimit, Bashkia Cërrik në kuadër të zbatimit të tre programeve sociale, të strehimit njofton:

1. Të gjithë qytetaret e interesuar që plotësojnë kushtet:

a) **Kushtet e strehimit**, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;

iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;

iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;

v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;

vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.

b) **Kushtet familjare**, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:

i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;

ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;

iv) bashkëshortët, moshë e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.

c) **Kushtet sociale**, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:

i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;

ii) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;

iii) familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve;

iv) emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit;

v) familjet e policëve të rënë në detyrë;

vi) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);

vii) punonjësit e repartit RENE A;

viii) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

ix) viktimat e dhunës në familje;

x) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;

xi) anëtarët e komunitetit rom;

xii) anëtarë të komunitetit egjiptian;

xiii) të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të

Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;

xiv) vajzat nëna;

xv) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të

orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.

Të paraqesin aplikimet nga llogaria e tyre në portalin qeveritar e-Albania,ose pranë zyrës së strehimit që ofron asistencë për personat që nuk mund ta kryejnë vetë aplikimin.

2.Të gjitha familjet e pastreha që kanë aplikuar për t'u trajtuar me një nga programet social të strehimit dhe kanë përfituar statusin e familjes së pastrehë me Vendim të Këshillit të Bashkisë Cërrik, të rifreskojnë dokumentacionin ligjor nga data 01/10 /2023 deri më datë 05.11 .2023.

Dokumentat që Aplikanti duhet të paraqes për aplikim në sistemin "Strehimi":

Aplikimi për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, me përjashtim të rasteve të nevojës emergjente për strehim, **bëhet me dy faza.**

Në fazën e parë aplikantët paraqesin Individu/familja paraqet kërkesën për të përfituar nga programet e strehimit social në çdo kohë,

a) Identitetin, emrin, atësinë, mbiemrin;
c) Datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
ç) Objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e strehimit social;

d) Numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës;

dh) Adresën e kërkuesit;

e) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit;

ë) Statusin e punësimit;

f) Kushtin social, sipas nënndarjeve "i" deri në "xv", të shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr.

22/2018;

g) Kushtin e strehimit, sipas nënndarjeve "i" deri në "vi", të shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018;

gj) Kushtin familjar, sipas nënndarjeve "i" deri në "iv", të shkronjës "b", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018;

h) Kushtin ekonomik, ku evidentohen të ardhurat mujore të familjes, sipas përcaktimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018.

Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit.

Dosja e çdo aplikanti duhet të përmbajë dokumentacionin që vërteton

deklarimet e bëra në fazën e parë. Dokumentacioni që kërkohet në këtë fazë është, si më poshtë vijon:

a) Për të dhëna personale të aplikantit:

i) certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;

ii) vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes, në territorin e Republikës së Shqipërisë

ii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;

iii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;

iv) aktverifikim nga njësia vendore për:

- banesat në rrezik shembjeje;

- rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;

- banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.

v) Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;

vi) akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

i) certifikatë familjare;

ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

i) vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;

ii) vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;

iii) dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimt të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;

iv) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin

“emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;

v) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;

vi) urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;

vii) vetëdeklarim nëse individ/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane; viii) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin; ix) vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;

x) vërtetim me certifikatë familjare se individ i përket kategorisë vajzë-nënë.

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës “ç”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

i) vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t’i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

ii) dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;

iii) vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;

iv) vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

v) vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Vlerësimi e më pas kualifikimi i aplikantëve kryhet sipas tabelave të mëposhtme për secilin program strehimi

1.SISTEMI I PIKËZIMIT PËR VLERËSIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE SIPAS PROGRAMIT “BANESA SOCIALE ME QIRA” NË ZBATIM TË NENIT 16, TË LIGJIT NR 20/2020 PËR VITIN 2023

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
a)	Kushtet e strehimit	25
ii	Banojnë në banesa rrezik shembje	8
iv	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastrehë si rezultat i fatkeqsive natyrore.	7
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi	6
v	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastrehë si rezultat i zbatimit të një vendimi gjyqësor	4
b)	Kushtet familjare	25
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim femijë	8
iii	Familje me më shumë se katër femijë	7
iv	Çiftet e reja me moshe totale deri në 60 vjeç	6
ii	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk perzgjidhen për tu strehuar në institucionet publike të perkujdesjes shoqërore	4
c)	Kushtet sociale	25
xvi	Familje që trajtohen me ndihme ekonomike	8
i	Persona me aftësi të kufizuara (me mungese të plotë ose të pjesshme shikimi, paraplegjik ose tetraplegjik, të paaftë për punë, invalid të punës)	7
xiv	Vajzat nëna	6
xii	Familjet e Komunitetit Rom dhe Egjiptian	4
ç)	Kushtet ekonomike	25
i	Familje pa të ardhura	10
ii	Familje me të ardhura shumë të ulta	7
iii	Familje me të ardhura të ulta	6
iv	Familje me të ardhura mesatare	2

2.SISTEMI I PIKËZIMIT PËR VLERËSIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE SIPAS PROGRAMIT “PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE” NË ZBATIM TË NENIT 16, TË LIGJIT NR 20/2020 PËR VITIN 2023

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
a)	Kushtet e strehimit	25
iv	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastrehë si rezultat i fatkeqsive natyrore.	8
ii	Banojnë në banesa rrezik shembje	7
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit	6
v	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastrehë si rezultat i zbatimit të një vendimi gjyqësor	4
b)	Kushtet familjare	25
iv	Çiftet e reja me moshe totale deri në 60 vjeç	8
iii	Familje me më shumë se katër femijë	7
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim femijë	6
ii	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk perzgjidhen për tu strehuar në institucionet publike të perkujdesjes shoqërore	4
c)	Kushtet sociale	25
	Persona me aftësi të kufizuara (me mungese të plotë ose të	

i	pjesshme shikimi,paraplegjik ose tetraplegjik ,të paaftë për pune,invalid të punës)	7
xvi	Familje qe trajtohen me ndihme ekonomike	6
xiv	Vajzat nëna	5
ix	Viktima të dhunës në familje	4
xii	Familjet e Komunitetit Rom dhe Egjipian	2
xvii	Asnje nga kushtet	1
ç)	Kushtet ekonomike	25
i	Familje pa të ardhura	9
ii	Familje me të ardhura shumë të ulta	8
iii	Familje me të ardhura të ulta	6
iv	Familje me të ardhura mesatare	2

3.SISTEMI I PIKËZIMIT PËR VLERËSIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE SIPAS PROGRAMIT PROGRAMIT “BANESA ME KOSTO TË ULËT” , NË ZBATIM TË NENIT 16, TË LIGJIT NR 20/2020 PËR VITIN 2023

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
a)	Kushtet e strehimit	25
ii	Banojnë në banesa rrezik shembje	8
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit	7
iv	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastrehë si rezultat i fatkeqsive natyrore.	6
v	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastrehë si rezultat i zbatimit të një vendimi gjyqësor	4
b)	Kushtet familjare	25
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim femijë	8
iii	Familje me më shumë se katër femijë	7
iv	Çiftet e reja me moshe totale deri në 60 vjeç	6
ii	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk perzgjidhen për tu strehuar në institucionet publike të perkujdesjes shoqërore	4
c)	Kushtet sociale	25
i	Persona me aftësi të kufizuara(me mungese të plotë ose të pjesshme shikimi,paraplegjik ose tetraplegjik ,të paaftë për pune,invalid të punës)	8
xiv	Vajzat nëna	7
ix	Viktima të dhunës në familje	2
xii	Familjet e Komunitetit Rom	4
xii	Familjet e Komunitetit Egjipian	4
ç)	Kushtet ekonomike	25
iv	Familje me të ardhura mesatare	20
iii	Familje me të ardhura të ulta	5